

VENDIM
Nr.65, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË SARANDËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Sarandës, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës së Pavlit (SRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 1332 ha-sh;

2.2 Zona e fushës Konispol-Zare (SRK-7), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 5000 ha-sh;

2.3 Zona e fushës së Vurgut (SRK-2, DLK-1), me sipërfaqe prej 3643 ha-sh, nga e cila 900 ha me ngritje mekanike;

2.4 Zona e fushës së Vagalatit (SRK-3, SRK-4), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 1585 ha-sh;

2.5 Zona e fushës së Gravës (SRK-4), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 348 ha-sh;

2.6 Zona e fushës së Butrintit (SRK-6), që kullon me ngritje mekanike në sipërfaqen prej 800 ha-sh;

2.7 Zona e fushës së Borshit (SRK-8), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 130 ha-sh;

2.8. Zona e fushës së Volloderit (SRK-9), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 160 ha-sh;

2.9 Zona e fushës së Navaricës (SRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 250 ha-sh;

2.10 Zona e fushës së Vurgut, Delvinë (DLK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen 2743 ha-sh;

2.11 Zona e fushës Stjar-Mesopotam (DLK-2), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 200 ha-sh;

2.12 Zona e fushës së Vergo-Kalasë (DLK-3), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 400 ha-sh;

2.13 Pendët mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve, bregdetare dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.14 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

b) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 1 (një) përfaqësues i qarkut;

d) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;

dh) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj, me nga 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano